Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2023/0477

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetarja e OSHP-së, në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (Ligji nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068, i plotësuar dhe Ligjin 05/L-092) në përbërjen nga Vedat Poterqoi Kryetar, panelist individual, duke vendosur sipas ankesës së (OE) "Sfinga" sh.p.k.,me seli në Prizren, kundër vendimit për dhënie të kontratës, lidhur me aktivitetin e prokurimit "Ekranat informues në hyrje të Qytetit" me numër të prokurimit OB614-23-5428-1-2-1, inicuar nga autoriteti kontraktues (AK)-Kuvendi Komunal-Obiliq, më 05/09/2023, mori këtë:

Vendim

1. Refuzohet, si e pabazuar ankesa e "Sfinga" SH.P.K. me nr. 2023/0477 , e datës 10/07/2023, lidhur me aktivitetin e prokurimit "Ekranat informues në hyrje të Qytetit", me numër të prokurimit OB614-23-5428-1-2-1, inicuar nga autoriteti kontraktues (AK)-Kuvendi Komunal Obiliq.

2. Në përputhje me nenin 31 pika 5, të Rregullores së Punës së OSHP-së, operatorit ekonomik ankues i konfiskohet tarifa e ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës, kurse mjetet kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale –

Me 29.05.2023,Kuvendi Komunal-Obiliq, në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar Njoftimin për Kontratë, ndërsa me datë 09.06.2023, është bërë hapja e ofertave.

Me datë 20.06.2023, ka publikuar B58 njoftimin mbi vendimin për dhënie të kontratës për aktivitetin e prokurimit me titull: "Ekranat informues në hyrje të Qytetit" me numër të prokurimit OB614-23-5428-1-2-1, ku ishte rekomanduar për kontratë Grup i Operatorëve Ekonomik N.SH. "Liriu"N.N.SH.& "World Medium", Brig.123, 23000, Suharekë.

OE ankues "Sfinga" sh.p.k., me datën 26.06.2023, ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim në AK. Me datën 30.06.2023, AK- Kuvendi Komunal-Obiliq, me vendim ka refuzuar kërkesën për rishqyrtim të OE ankues dhe ka vërtetuar vendimin e autoritetit kontraktues të datës 20.06.2023.

I pakënaqur me vendimin e AK-së, OE ankues "Sfinga" sh.p.k., me vendimin për dhënie të kontratës për procedurën e prokurimit të sipërshënuar me datë 10.07.2023, ka parashtruar ankesë në OSHP, me numër të protokollit 2023/477.

Ankesa e OE është ushtruar në pajtim me nenin 109.1, të LPP, sipas të cilit kundër çdo vendimi të marrë nga AK çdo palë e interesuar mund të parashtrojë ankesë pranë OSHP. Meqë OE ka ushtruar po ashtu kërkesë për rishqyrtim, do të thotë se veprimet e të njëjtit i referohen po ashtu dhe nenit 108/A të Ligjit të cituar. Prandaj OSHP konsideron se Ankesa i plotëson kushtet e parapara në kuptim të dispozitave tani më të cituara dhe e njëjta bie nën kompetencat e tij në kuptim të nenit 105, të LPP-së.

Autoriteti kontraktues Kuvendi Komunal-Obiliq gjatë këtij aktiviteti të prokurimit ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës: furnizim, vlera e parashikuar e kontratës: 58,000.00 €.

Organi Shqyrtues i Prokurimit i ka njoftuar palët me datë: 26.07.2023, me raportin e ekspertizës. AK Kuvendi Komunal-Obiliq, me datë 26.07.2023, ka deklaruar se pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues, ndërkaq OE ankues "Sfinga" sh.p.k.,me 31.07.202, ka deklaruar se nuk pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

- *Vlerësimi dhe administrimi i provave –*

OSHP ka angazhuar ekspertin e jashtëm shqyrtues të prokurimit që në pajtim nenin 113 të LPP-së, ta bëjë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve ankimore i cili në raportin e datës 26 korrik 2023, ka rekomanduar që:

•Refuzohet si e pa bazuar ankesa e "Sfinga" sh.p.k.,me seli në Prizren,

•Të mbetet në fuqi njoftimi mbi vendimin e AK-së i datës 20.06.2023 (njoftimi për dhënie të kontratës).

Paneli Shqyrtues konsideroi se lidhur me çështjen në rastin konkret, nuk ka nevojë të konvokohet seanca dëgjimore me palë, konform nenit 24 paragrafi 1, i Rregullores së Punës së OSHP, përderisa pretendimet e palëve, provat, parashtresat e tyre dhe ekspertiza e ekspertit shqyrtues, ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritor.

<u>Përgjigje në pretendimet ankimore të OE ankues "Sfinga" sh.p.k.,me seli në Prizren</u>

<u>Sqarim hyrës:</u> Autoriteti Kontraktues Kuvendi Komunal Obiliq, ka zhvilluar aktivitetin e prokurimit me titull: "Ekranat informues në hyrje të Qytetit", me numër të prokurimit: OB614-23-5428-1-2-1, procedurë e hapur, lloji i kontratës: Furnizim, vlera e parashikuar e kontratës: 58,000.00 €.

Autoriteti Kontraktues ka publikuar Njoftimin për Kontratë me datën 29.05.2023, Ndërsa AK me datë 20.06.2023 ka nxjerrë Njoftimin mbi Vendimin e AK-së. Me datë 26.06.2023, OE-"SFINGA" SH.P.K., ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim pranë AK-së, kundër vendimit te AK-së.

Ndërsa, AK me datë 30.06.2023 ka nxjerrë vendim për refuzimin e kërkesës për rishqyrtim, rrjedhimisht kundër këtij Vendimi të AK-së, me datë 10.07.2023 OE-"SFINGA" SH.P.K., ka parashtruar ankesë pranë OSHP-së.

Eksperti shqyrtues i prokurimit, sipas autorizimit 2023/0477, dhe në pajtim me nenin 114 të LPP-së, i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues dhe për të njëjtat i ka këto të gjetura dhe konstatime:

<u>Pretendimi ankimor i OE ankues</u>

"Pas qasjes ne dokumente qe kemi pasur, kemi vërejtur se AK-ja ka rekomanduar për kontrate GO ekonomik te pa përgjegjshëm te cilët nuk i plotësojnë kërkesat e FDT-së dhe dosjes se tenderit. Ne këto pretendime i kemi sqaruar ne kërkesën për rishqyrtim si ne vijim: 1.KATALOG për këto produkte. OE i

rekomanduar për kontrate N.SH. Liriu , bazuar ne veprimtarin e deklaruar ne Info të Biznesit dhe ne kontratat e ofruara nuk është kompani prodhuese por është kompani SHERBYESE. Andaj Katalogu ofruara ka të bëjë me SHERBIME e kurrsesi me produkte. PRODUKETET PER EKRANE DIGJITALE janë produkte qe prodhohen jashtë Kosovës pra importohen. Kjo do te thotë se OE "Liriu" nuk ka ofruar KATLAOG TE PRODUKETVE - EKRAN DIGJITALE qe lidhen kërkesën ne dosje te tenderit".

Përgjigje pretendimit ankimor:

Eksperti shqyrtues e ka shqyrtuar këtë pretendim ankimor të OE ankues, pas shqyrtimit dhe analizimit të dokumentacionit tenderik, sqaron se: Autoriteti Kontraktues gjatë hartimit të dosjes së tenderit për këtë aktivitet të prokurimit, përveç tjerash, në kërkesat e vendosura në dosjen e tenderit dhe në njoftim për kontratë (Kërkesat dhe Dëshmitë), konkretisht te Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale neni 9.1 & 9.2, ka përcaktuar kërkesat (dokumentet) për Operatorët Ekonomik, si më poshtë:

Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe profesionale:

Kërkesa nr.5. OE duhet të ofroj katallogun e produkteve të kompanisë me kod dhe shifër për secilin produkt.

Dëshmia e kërkuar dokumentare:

Dëshmia nr.5. Katallogu duhet të jetë i nënshkruar dhe i vulosur nga OE.

Eksperti Shqyrtues, pas shqyrtimit dhe analizimit të dokumentacionit tenderik dhe shkresave të lëndës në platformën e-prokurim, përkatësisht pretendimit ankimor të OE ankues kundrejt OE të rekomanduar për kontratë, gjithnjë duke u bazuar në kërkesën e lartcekur të dosjes së tenderit, konsideroj se, sipas formulimit të kërkesës në dosjen e tenderit, katalogu i dorëzuar nga OE i rekomanduar për kontratë e plotëson kërkesën e dosjes së tenderit dhe në njoftimit për kontratë, meqenëse AK në dosjen e tenderit ka kërkuar që Operatorët Ekonomik të ofrojnë katallogun e produkteve të kompanisë me kod dhe shifër për secilin produkt, pa e specifikuar çështjen e prodhimit ose importimit të produkteve si dhe çështjen autorizimit nga prodhuesi për produktet e ofruara. Pra, përveç përshkrimit të lartcekur, AK nuk ka kërkuar diçka tjetër specifike që katallogu duhet ti përmbaj. Andaj pretendimi i OE ankues në këtë pike është i pa bazuar.

Ky konstatim mbështetet në faktin se: Paragrafi 3 i nenit 56 të LPP-së përcakton:

"Tenderuesi, gjatë procedurave të hapura, ose kandidati, gjatë procedurave të kufizuara dhe procedurave konkurruese me negociata, nuk do të diskualifikohet ose përjashtohet nga procedurat e tilla në baza të ndonjë kërkese ose kriteri që nuk është i cekur në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit".

Pretendimi ankimor i OE ankues 2

Kontrata për Rimorkio Sinjalizuese është gjenerale dhe nuk ka të bëjë me DT të cilën e ka publiku AK Komuna e Obiliqit.

Përgjigje Pretendimit ankimor:

Eksperti Shqyrtues, pas shqyrtimit dhe analizimit të dokumentacionit tenderik dhe shkresave të lëndës në platformën e-prokurim, përkatësisht pretendimit ankimor të OE ankues kundrejt OE të rekomanduar për kontratë, gjithnjë duke u bazuar edhe në kërkesën e lartcekur në dosjen e tenderit, sa i përket pretendimit ankimor të OE ankues, për Rimorkion me Sinjalizues, OE pretendon se kontrata është shumë e përgjithshme dhe nuk përmban as titullin dhe as numrin e aktivitetit të prokurimit dhe nuk ka të bëj fare me këtë aktivitet të prokurimit.

Lidhur me këtë pretendim ankimor, Eksperti shqyrtues sqaron se, në dosjen e tenderit nuk ka qenë kërkesë që kontrata të përmbaj titullin dhe as numrin e aktivitetit të prokurimit, por te dëshmia dokumentare në dosjen e tenderit kërkohet që "Dëshmia nr.4. Lista e pajisjeve duhet të dorëzohet në origjinal, ku duhet ti bashkëngjiten, fotografit ku identifikohen pajisjet e kërkuara dhe njëra nga këto dëshmi kopje të librezës së qarkullimit, ose DUD doganorë, ose faturë për blerjen ose Kontrata mbi qiramarrjen, për marrëveshjet e qirasë duhet ta dorëzoni marrëveshjet e noterizuara", andaj kontrata për Rimorkion me Sinjalizues e prezantuar nga OE i rekomanduar për kontratë është në përputhje me kërkesën në dosjen e tenderit dhe njoftimit për kontratë. Andaj ky pretendim i OE ankues është i pa bazuar.

Pretendimi ankimor i OE ankues 3

Lidhur me kërkesën për KONA, OE "Liriu" ka ofruar fatura nga kompania Donitrade por nuk ka ofrue dëshmi për transfer bankar qe lidhet me faturën.

Përgjigje pretendimit ankimor:

Eksperti Shqyrtues, pas shqyrtimit dhe analizimit të dokumentacionit tenderik dhe shkresave të lëndës në platformën e-prokurim, përkatësisht pretendimit ankimor të OE ankues kundrejt OE të rekomanduar për kontratë, gjithnjë duke u bazuar edhe në kërkesën e lartcekur në dosjen e tenderit, sa i përket pretendimit ankimor të OE ankues, lidhur me kërkesën për KONA, ku thuhet se, OE "Liriu" ka ofruar fatura nga kompania Donitrade por nuk ka ofruar dëshmi për transfer bankar që lidhet me faturën.

Lidhur me këtë pretendim ankimor Eksperti shqyrtues sqaron se, në dosjen e tenderit nuk ka qenë kërkesë që OE për kërkesën në fjalë të dëshmoj me trensfere bankare, por te dëshmia dokumentare në dosjen e tenderit kërkohet që "Dëshmia nr.4. Lista e pajisjeve duhet të dorëzohet në origjinal, ku duhet ti bashkëngjiten, fotografit ku identifikohen pajisjet e kërkuara dhe njëra nga këto dëshmi kopje të librezës së qarkullimit, ose DUD doganorë, ose faturë për blerjen ose Kontrata mbi qiramarrjen, për marrëveshjet e qirasë duhet ta dorëzoni marrëveshjet e noterizuara", andaj fatura për KONAT e prezantuar nga OE i rekomanduar për kontratë është në përputhje me kërkesën në dosjen e tenderit dhe njoftim për kontratë. Andaj ky pretendim i OE ankues është i pa bazuar.

Eksperti shqyrtues sqaron se, kurdo që AK dyshon në ndonjë informacion të dorëzuar nga OE, sipas paragrafit 7 të nenit 52 të LPP-së, "Autoriteti kontraktues në rast të dyshimit të cilitdo informacion të dorëzuar nga operatori ekonomik, do të kryej një kontroll efektiv të informatave dhe dokumentacionit të tenderit".

Pretendimi ankimor i OE ankues: 4.

OE "LIRIU" nuk ka ofruar asnjë kontrate qe dëshmon realizim te ekraneve digjitale LED të cilës do forme qofte ne hyre e dalje te qyteteve , brenda tyre apo ne cilin do event".

Përgjigje Pretendimit ankimor:

Eksperti Shqyrtues, pas shqyrtimit dhe analizimit të dokumentacionit tenderik dhe shkresave të lëndës në platformën e-prokurim, përkatësisht pretendimit ankimor të OE ankues kundrejt OE të rekomanduar për kontratë, gjithnjë duke u bazuar edhe në kërkesën e lartcekur në dosjen e tenderit, sa i përket pretendimit ankimor të OE ankues, se "OE LIRIU nuk ka ofruar asnjë kontrate që dëshmon realizim të ekraneve digjitale LED të cilës do form qoftë në hyre e dalje të qyteteve, brenda tyre apo ne cilin do event.

Lidhur me këtë pretendim ankimor, Eksperti shqyrtues sqaron se, Autoriteti Kontraktues gjatë hartimit të dosjes së tenderit për këtë aktivitet të prokurimit, përveç tjerash, në kërkesat e vendosura në dosjen e tenderit dhe në njoftim për kontratë (Kërkesat dhe Dëshmitë), konkretisht te Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale neni 9.1 & 9.2, ka përcaktuar kërkesat (dokumentet) për operatorët

ekonomik, si më poshtë:

Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe profesionale:

Kërkesa nr.1. Operatori ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses kontrata të natyrës së ngjashme, gjatë 3 (tri) vitet e fundit (duke filluar nga data e publikimit te këtij njoftimi për kontrate) jo me pak se;45,000.00 €. Në rast të grupit Lideri duhet ti ketë së paku 60% të shumës së kërkuar për furnizime të ngjashme

Dëshmia e kërkuar dokumentare:

Dëshmia nr.1. Lista e kontratave të realizuara ku duhet saktësuar titullin e kontratës, shumën e kontratës, datën e përfundimit dhe përfituesin si dhe listës ti bashkëngjiten kontratat, referencat ose certifikatat për realizimin e projekteve të natyrës së ngjashme.

Eksperti shqyrtues sqaron se, sipas kërkesës së lartcekur, AK ka kërkuar dëshmi se OE ka përfunduar me sukses kontrata të natyrës së ngjashme dhe nuk ka kërkuar dëshmi se OE ka përfunduar me sukses kontrata të natyrës së njëjtë, Pra në rastin konkret, AK nuk ka kërkuar kontrata të natyrës së njëjtë (Ekrana Informues). Andaj, Lista e Kontratave të prezantuar nga OE i rekomanduar për kontratë, i përgjigjet natyrës së kontratës dhe e plotëson kërkesën e dosjes së tenderit dhe qëllimit të kontratës, rrjedhimisht ky pretendim i OE ankues është i pa bazuar.

Pretendimi ankimor i OE ankues5.

OE Sinjalizimi nuk ka ofru fotot e kamionëve me kran, edhe pese kjo ka qenë kërkesë decidive ne FDT.

Eksperti shqyrtues sqaron se, këtë pretendim ankimor nuk e ka shqyrtuar fare, për faktin se, duke pas parasysh se OE ankues në pajtim me nenin 108/A të LPP-së, ka pasur mundësi dhe është dashur që paraprakisht të gjitha pretendimet ankimore ti parashtron pranë AK, e që në rastin konkret OE ankues, këtë pretendim nuk e ka parashtruar fare pranë AK-së në kërkesën për rishqyrtim, prandaj duke u bazuar në nenin 64 paragrafin 2 të Rregullores për Prokurimin Publik, e cila përcakton se: "Ankesa do të përgatitet dhe dorëzohet tek Organi Shqyrtues i Prokurimit nëpërmjet sistemit të prokurimit elektronik, funksionit të dedikuar "Ankesat". Pretendimet ankimore duhet të jenë të njëjta me ato të paraqitura në kërkesën për rishqyrtim pranë Autoritetit Kontraktues", si dhe neni 13 paragrafi 9 i Rregullores së OSHP-së Nr. 01/2020, e datës 03.03.2020 në të cilën thuhet se: "Ankesat duhet të jenë të qarta, e shkurtër, dhe me pretendimet e supozuara që eventualisht janë shkelur nenet e caktuara të LPP-së, nga ana e autoritetit kontraktues. Pra, sipas dispozitave të larte cituar, pretendimet ankimore duhet të jenë të njëjta me ato të paraqitura për autoritetin kontraktues", andaj meqenëse ky pretendim ankimor nuk ka qenë në kërkesën për rishqyrtim pranë AK-së, si i tillë nuk është trajtuar nga eksperti shqyrtues për arsyet e cekura më lartë.

Eksperti shqyrtues i prokurimit, ka shqyrtuar të gjitha pretendimet ankimore të OE ankues të paraqitura në kërkesën për rishqyrtim, andaj duke u bazuar në sqarimet e lartë përmendura, konsideroj se, AK ka bërë vlerësimin e tenderëve në pajtim me paragrafin 4 të nenit 59 të LPP-së.

Paragrafi 4 i nenit 59 të LPP, përcakton :

"Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit. Pavarësisht nga e mëparshmja, autoriteti kontraktues mund të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm nëse: (i) përmban vetëm gabime ose paqartësi të cilat mund të korrigjohen pa ndryshuar kushtin material apo aspektin e tenderit ne fjalë, ose (ii) përmban vetëm devijime të vogla që nuk mund të shkaktojnë ndryshime materiale ose devijime nga karakteristikat, kushtet, dhe kërkesat e tjera të parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit; me kusht që, çfarëdo devijimi i tillë të kuantifikohet, aq sa është e mundshme, dhe të merret parasysh gjatë vlerësimit dhe krahasimit të tenderëve".

Gjithashtu, Autoriteti Kontraktues gjatë zbatimit të dispozitave të LPP-së dhe legjislacionit dytësor gjithmonë duhet të bazohet në qëllimin e tij të përcaktuar me paragrafin 1 të nenit 1, si në vijim, citoj:

"Qëllimi i këtij ligji është të sigurojë mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë..."

Po ashtu, sipas paragrafit 1 të nenit 6 të këtij ligji, të gjitha autoritetet kontraktuese janë të obliguara që të sigurojnë që fondet publike dhe burimet publike të përdoren në mënyrën më ekonomike njëkohësisht duke marrë në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit.

REKOMANDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues refuzohet si e pabazuar dhe të mbetet në fuqi vendimi i AK.

- Konstatimet e Panelit Shqyrtues -

Paneli konstatoi se nuk ekzistojnë elementet për parandalim të konfliktit të interesit, siç kërkohet në kuptim të nenit 11 të Rregullores për Punën e OSHP, prandaj analizoi të gjitha shkresat e kësaj lënde, përfshirë të gjitha aktet dhe veprimet e palëve dhe konsideroi se nuk ka nevojë të konvokohet seanca publike me palë sepse ka prova të mjaftueshme për të vendosur sipas paragrafit 1, të nenit 24 të Rregullores së cituar. Paneli në ketë rast mori në konsideratë të gjitha pohimet ankimore, aktet dhe veprimet e AK dhe raportin e ekspertit.

Në fakt (natyrisht pavarësisht nga rekomandimet) Paneli vëren se procedura e prokurimit e cila është aplikuar në ketë rast është prezantuar në detaje në raportin e ekspertit shqyrtues, duke i shpjeguar të gjitha fazat e procesit dhe veprimet e ndërmarra nga palët në kontekstin krahasues me aktet në fuqi, posaçërisht me Rregullat për Prokurim Publik.

Prandaj duke ju referuar nenit 104.1, të LPP, sipas të cilit kërkohet që procedura e shqyrtimit të zbatohet në mënyrë të shpejt, të ligjshme dhe efektive dhe duke i analizuar po ashtu në tërësinë e tyre shkresat e kësaj lënde në kontekstin e këtij procesi të prokurimit, Paneli nuk e konsideroi të nevojshme ta shtjelloj sërish në detaje dhe pa nevojë në ketë rast secilin pretendim ankimor, përderisa të njëjtat në mënyrë specifike janë veçuar sidomos në vendimin e atakuar të autoritetit kontraktues dhe janë analizuar dhe argumentuar pa vërejtje nga ana e këtij Paneli. Krahas tjerash, në vendimin e atakuar të autoritetit kontraktues dhe në raportin e ekspertit shqyrtues janë dhenë shpjegime të drejta po ashtu edhe lidhur me pohimet ankimore. Paneli vëren se arsyet e dhëna në vendimin e atakuar të autoritetit kontraktues janë profesionale dhe të argumentuara pa vërejtje me prova materiale, pa nevojë që të përshkruhen sërish. Prandaj Paneli mbështet shpjegimet e ekspertit shqyrtues i cili ka shpjeguar se në raportin e ekpertizës së tij.

Prandaj bazuar në faktet dhe rrethanat e shpjeguara shkurtimisht si më sipër në shkresat e kësaj lënde nuk gjendet ndonjë provë se AK ka aplikuar ndonjë kriter apo veprim që diskriminon, redukton apo eliminon konkurrencën në mes të operatorëve ekonomik.

- Përfundim -

Nisur nga shpjegimet si më sipër Paneli konsideron se AK ka vepruar në harmoni me dispozitat e cituara si më sipër të LPP dhe ka zbatuar drejtë dosjen e tenderit sikurse parashihet me paragrafin 1, të nenit 27, sipas të cilit, autoriteti kontraktues përpilon dosjen e tenderit me të gjitha informatat përkatëse përfshirë të gjitha termet dhe kushtet materiale të saj, procedurat e zbatueshme të prokurimit, çfarëdo kërkese të aplikueshme të përshtatshmërisë ose ndonjë kriter të përzgjedhjes, procedurat e ankesës si dhe informatat e tjera përkatëse siç kërkohen nga ky ligj ose siç i sheh të domosdoshme autoriteti kontraktues. Në kuptim të kësaj dispozite, dosja e tenderit përbën dokumentin kryesor të prokurimit dhe se publikimi i sajë supozohet të jetë në harmoni të plotë me qëllimet e LPP, të siguroj mënyrën efikase të shfrytëzimit të fondeve publike, të promovoj integritetin e vet procesit të prokurimit dhe të kulturës institucionale dhe të profesionalizuar.

Ndonëse mendimi i ekspertit nuk është detyrues, Paneli sipas mendimit të pavarur të tij e ka mbështetur raportin e ekspertit në rastin konkret, nisur nga parimi se vlera provuese e tij jepet gjithnjë me raport me vlerësimin, krahasimin dhe administrimin e të gjitha provave tjera dhe natyrën e një çështje në rastin konkret.

Paneli shqyrtues konsideron se vendimi i marrur në ketë çështje është i bazuar në administrimin e të gjitha provave, në dispozicion të kësaj lënde dhe se në marrjen e vendimeve gjithmonë ka parasysh nenin 6, si dhe 1 të LPP-së, ku qëllimi i këtij ligji është të siguroj mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese. Paneli Shqyrtues niset gjithnjë nga fakti se autoritetet kontraktuese ushtrojnë pavarësinë e tyre institucionale në procesin e prokurimit publik, mirëpo mbetet në detyrimin e tyre eksplicit respektimi i ligjshmërisë në procesin e prokurimit.

Andaj nga të lartcekurat, paneli shqyrtues ne pajtim me nenin 117 të LPP-së vendosi si në dispozitv të këtij vendimi.

Kryetar i Panelit Shqyrtues

Vedat Poterqoi

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës Komerciale - Departamentit për çështje Administrative për anulim vendimi në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të vendimit.

Vendimi t'i dorëzohet:

- AK - **KUVENDI KOMUNAL - OBILIQ**
- OE - **Sfinga SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: